



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dërguar Pratien / Prodato Received / Delivered	28.04	2022	2	viti god year
Organ / Rjeshtja Organ / Rjedmita Org / Unit	Hi / Prot Hi / Prot Prot No	Shkupja Punëq Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKDM/UK	2501/2022		1/5	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.254/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.254/2022 të datës 21.03.2022 të parashtruar nga

të cilin me autorizim e përfaqëson me adresë Prishtinë, kundër Vendimit me numër protokolli 499 të datës 22.02.2022 të Ministres së Ministrisë të Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 28.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.254/2022 e datës 21.03.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimit me numër protokolli 499 i datës 22.02.2022 të Ministres së Ministrisë të Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, përmes përfaqësuesit me autorizim më datë 21.03.2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me numër protokolli 499 të datës 22.02.2022 të Ministres së Ministrisë të Punëve të Jashtme dhe Diasporës, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës administrative dhe shkeljes së dispozitave të ligjit material.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej referuar Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.03.2022 ka proceduar



kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (tutje MPJD) kjo e fundit me datë 24.03.2022 ka dorëzuar përgjigjen në ankesë me numër protokolli 1580/2022 se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.254/2022 të datës 21.03.2022 me numër protokolli 1462/2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokolli 499 të datës 22.02.2022 të Ministres së Ministrisë të Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Akt Emërimit të datës 21.05.2012 dhe 21.05.2013 në emër të ankuesit; Emailin e datës 04.02.2022 nga Zyra e Sekretarit në MPJD për nëpunësit e MPJD-së; Autorizimin e datës 16.02.2022; Kërkesën për Përgjigje në ankesë e datës 23.03.2022; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 1580/2022 e datës 24.03.2022; Kërkesën nga MPJD për Vlerësimin e ndikimit buxhetor të projekt rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës me numër protokolli 51 e datës 11.01.2022 për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve; Miratimin Paraprak me Nr.0819/2021 të datës 24.12.2021 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Vendimin me Nr. Ref:90/2022 i datës 15.02.2022 për lejimin e pushimit pa pagesë për ankuesin; Vendimin Nr.Ref:80/2022 i datës 14.03.2022 për sistemim të përkohshëm të ankuesit; Akt Emërimit me numër të aktit 090 i datës 21.05.2012 në emër të ankuesit; Akt Emërimit me numër të aktit 90 i datës 21.05.2013 në emër të ankuesit; Dekretin e Presidencës Nr.203/2021 nga Zyra e Presidencës; Dekretin me Nr. 203/2021 i datës 29.12.201 nga Presidentja e Republikës së Kosovës; Vendimin me numër protokolli 168 i datës 20.01.2022 i Ministres së Ministrisë të Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vendimin V.nr.01/KR/2022 i datës 24.02.2022 për themelimin të Komisionit të Ristrukturimit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vendimin me Nr.214/2022 i datës 01.02.2022 i Kryeministrit të Republikës së Kosovës për Miratimin e Rregullores (ZKM) Nr.01/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vendimin Nr.Ref:08/2017 i datës 16.01.2017 për emërimit të ankuesit në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Zagreb; Vendimin Nr.645/18 i datës 23.07.2018 për vazhdimin e mandatit të misionit diplomatik për ankuesin në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Zagreb; Dekreti Nr. 209/2019 i datës 11.10.2019 për emërimit të ankuesit Shef i Misionit/Ambasador i Republikës së Kosovës në Mbretërinë e Norvegjisë me seli në Oslo; Vendimin MPJ/DP/29/14 i datës 29.04.2014 për transferim të ankuesit në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Zagreb; Vendimin Nr. Ref:275/2014 i datës 30.04.2014.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat e lëndës ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pabazuar, sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesi në bazë të Akt Emërimit me numër të aktit 090 të datës 21.05.2012 është emëruar në pozitën Zëvendës drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshëm në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme. I njëjti me Dekretin Nr.209/2019 të datës 11.10.2019 të Presidentit të Republikës së Kosovës është emëruar Ambasador i Republikës së Kosovës në Mbretërinë e Norvegjisë me seli në Oslo, kurse në bazë të Dekretit me Nr.203/2021 të datës 29.12.2021 të Presidentes së Republikës së Kosovës urdhërohet tërheqja e tij nga pozita e Shefit të Misionit/Ambasadorit të Republikës së Kosovës në Mbretërinë e Norvegjisë. Në zbatim të Dekretit Nr.203/2021 të datës 29.12.2021, Ministria e MPJD-së përmes Vendimit



Nr.Ref.19/2022 të datës 20.01.2022 ka liruar ankuesin nga pozita Shef i Misionit/Ambasador i Republikës së Kosovës në Mbretërinë e Norvegjisë duke vendosur që kthimi i tij të bëhet më datë 25.02.2022.

Ministrja e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës më datë 22.02.2022 ka nxjerrë Vendim Nr.Ref:77/2022 dhe numër protokolli 499, me të cilin në pikën 4 ka bërë shfuqizimin e Vendimit me Nr.19/2022 të datës 20.01.2022, duke theksuar që kthimi i ankuesit nga Shef i Misionit/Ambasador i Republikës së Kosovës në Mbretërinë e Norvegjisë bëhet më datë 15.03.2022, ndërsa është obliguar Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Njësia e Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi në përputhje me Rregulloren (ZKM) Nr.01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe aktet e tjera në fuqi.

Me tutje, bazuar në provat e lëndës rezulton se Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me Vendimin Nr.Ref:80/2022 të datës 14.03.2022 ka bërë sistemimin e përkohësisht të ankuesit në pozitën Drejtor i Departamentit për Azi dhe Oqeani në Ministrinë e Punës të Jashtme dhe Diasporës duke filluar nga data 16.03.2022.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që ky vendim është nxjerrë me shkelje të dispozitave procedurale dhe materiale, konkretisht në kundërshtim me Ligjin për Shërbimin e Jashtëm dhe Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Me tej shton se shuarja e pozitës Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm me Rregulloren e Re për Organizimin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë Punëve të Jashtme dhe Diasporës është në kundërshtim me Ligjin për Shërbimin e Jashtëm. Propozon që të aprovohet ankesa si e bazuar, të shfuqizohet Vendimi me numër protokolli 499 i datës 22.02.2022 të Ministres së Ministrisë të Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe t'i njihet statusi sipas Akt Emërimit në fuqi si Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses përkitazi me ligjshmërinë e Vendimit të Ministres së MPJD-ës për tërheqje nga misioni diplomatik, Kolegji nga vlerësimi i provave materiale ka konstatuar se Vendimit me numër protokolli 499 i datës 22.02.2022 është nxjerrë në zbatim të Dekretit me Nr. 203/2021 të datës 29.12.2021 të Presidentes së Republikës së Kosovës më të cilin ishte urdhëruar tërheqja ankuesit nga misioni diplomatik respektivisht nga Shef i Misionit/Ambasador i Republikës së Kosovës në Mbretërinë e Norvegjisë. Ndërlidhur me këtë pretendim Kolegji ju referua dispozitave të Ligji Nr.06/L-114 për Zyrat e Publikë përkatësisht nenit 3 paragrafi 2 nënparagrafi 2.3 me të cilin është përcaktuar se: *Ky ligj nuk zbatohet për: funksionarët e emëruar nga Kuvendi apo nga Presidenti i Republikës dhe titullarët apo anëtarët e organeve drejtuese kolegjiale të institucioneve të pavarura dhe të agjencive të pavarura si dhe Ligjit Nr.03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.03/L-207, konkretisht nenit 8 ku përcaktohet se: Anëtarët e Shërbimit Diplomatik të Kosovës, përveç të emëruarve politik, janë pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe personeli i tij i nënshtrohet të njëjtave paga, kërkesa dhe kushte të punës, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj ose me ligje tjera ose akte nënligjor.* Andaj në kuptim të këtyre dispozitave ligjore Kolegji konstaton se ambasadoret si të emëruar politik kanë statusin e funksionareve publik, kështu që nisur nga ky konstatim si dhe në mbështetje të dispozitave të nenit 2 të Ligjit Nr.03/L-207 dhe nenit 23 të Ligjit Nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, rrjedhë se emërimi dhe tërheqja e parakohshme e Ambasadorëve dhe Shefave të Misioneve mund të bëhet vetëm nga Presidenti/ja i Republikës së



Kosovës me dekret, rrjedhimisht Kolegji vlerëson së vendimi i kundërshtuar me ankesë ka të bëjë vetëm me zbatimin e Dekretit Nr. 203/2021 të datës 29.12.2021 të Presidentes së Republikës së Kosovës, gjegjësisht mbi këto arsye ligjore Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil nuk ka mandat ligjor që të shqyrtoj ligjshmërinë e vendimeve të Presidentit/es të Kosovës përkitazi me tërheqjen e parakohshme të ambasadoreve nga misioni diplomatik.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit së shuarja e pozitës së Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm është në kundërshtim me Ligjin Nr. 03/L-122 për Shërimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, Kolegji bazuar në dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, vlerëson së organizimi i brendshëm i një institucioni përcaktohet varësisht nga fushëveprimi, lloji dhe kompleksiteti i detyrave dhe përgjegjësi të institucionit, me qëllim të zbatimit të mandatit ligjor, si dhe sigurimit të performancës së tyre efikase me një kosto efektive, e nisur nga ky konstatim rrjedhë se është në diskrecion të institucionit që të vendos lidhur me strukturën e brendshme të organizimit dhe funksionimit në mbështetje të parimeve të lartcekura.

Po ashtu Kolegji me rastin e shqyrtimin të pretendimit ankimor si me lartë, ju referua edhe nenit 54 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura me të cilin është përcaktuar se: *Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet, çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj*, si dhe nenit 12 të Rregullores (QRK) Nr.01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura ku shprehimisht është përcaktuar detyrimi i institucioneve të administratës shtetërore që në afat kohor prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje duhet të hartojnë Rregulloret përkatëse për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në pajtim me kërkesat ligjore të vendosura me këtë Rregullore dhe Ligjin Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura.

Andaj, bazuar si me lartë, e në kuptim të dispozitave të Udhëzimit Administrativ Nr.03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative, rezulton se Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës është akt i karakterit normativ që ka të bëjë më organizimin e brendshëm dhe funksionimin e këtij institucioni, e si rrjedhojë vlerësimi i ligjshmërisë dhe pajtueshmërisë përkitazi me zbatimin e standardeve nga institucionet e Administratës Shtetërore me rastin e Hartimit të Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, është përgjegjësi e ministrisë gjegjëse për administratë publike, e mbi këto arsye Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka kompetencë lëndore që të vlerësoj ligjshmërinë e akteve të natyrës së tillë.

Kolegji në mbështetje të nenit 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë konstaton se *Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejtë në KPMSHCK për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji, ndërlidhur me këtë neni 13 i Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative parasheh se: Përveç kur përjashtohet shprehimisht me ligj, secili person ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative dhe ato gjyqësore, në mënyrën e përcaktuar me ligj, kundër një*

veprimi apo mosveprimi administrativ të organit publik që i cenon një të drejtë apo një interes juridik. Kështu që në kuptim të këtyre dispozitave ligjore dhe duke nisur nga gjendja faktike e konstatuar si me lartë, Kolegji konstaton së ankuesi i prekur me procesin e ristrukturimit të organit të punësimit i garantohen të drejtat e përcaktuara me nenin 54 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, andaj çdo veprim apo mos veprim i organit të punësimit në kundërshtim me këto dispozita ligjore përbën shkak të ushtrimit të mjeteve juridike në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil kundërshtimit me mjete juridike.

Ashtu siç u tha me sipëri, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.254/2022

Avdyl BEKTESHI

Be Bekteshi
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunimin Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Ardita Haxhnikaj
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit Shoqërisë së Avokatëve
- Ministres së Ministrisë se Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë se Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

